



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:002906
Datë: 16.04.2024
Numri i dokumentit: 05579082

Ac.nr.4571/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi - kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Naim Mehulli - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B..... G..... nga fshati Godanc, Komuna Glllogoc, rruga “M..... F..... dhe M..... F.....”, nr.6, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson S..... M....., avokate nga Prishtina, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Sh.A, me seli në Prishtinë, rruga “Nëna Terezë”, nr.36, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson J..... M....., lidhur me çështjen kompensim i pagave jubilarë, duke vendosur sipas ankesës së paditësit të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.149/2020 të datës 24.03.2022 në seancën e kolegjit të mbajtur më 16.04.2024 nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e paditësit, B..... G..... nga fshati Godanc, Komuna Glllogoc, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.149/2020 i datës 24.03.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.149/2020 të datës 24.03.2022 në pikën e parë të dispozitivit e ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit B..... G..... nga fshati Godanc, Komuna Glllogoc, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Korporata Energjetike e Kosovës, Sh.A, me seli në Prishtinë, që paditësit në emër të tri pagave për shpërblimi jubilar t’ia paguajë shumën prej 2,034.00 euro, së bashku me kamatë ligjore 8% e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë 10.01.2020 e deri në pagesën definitive, si dhe t’ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 270.00 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përbarimit ligjor. Në pikën e dytë të dispozitivit e ka detyruar secilën palë që ti bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur paditësi, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtë materiale me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ta ndryshojë aktgjykimin e atakuar duke e aprovuar në tërësi si të themeltë kërkesëpadinë e paditësit e po ashtu ka kërkuar edhe shpenzimet procedurale.

E paditura nuk ka ushtruar përgjegje në ankesë.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, analizimit të të njëjtave, e në kuptim të nenit 194, 195 dhe 200 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të paditësit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi, B..... G..... nga fshati Godanc, Komuna e e Glllogocit, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, S..... M....., avokate nga Prishtina, me datë 10.01.2020 ka ushtruar padi kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës me seli në Prishtinë për kompensimin e pagave jubilarë. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura në përgjigje në padi, në seancat e mbajtura gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare, përmes të autorizuarit të tij, e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, me arsyetimin se në këtë çështje juridike kemi të bëjmë me kërkesë të parashkruar. Me tej ka shtuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie të punës tek e paditura që nga viti 1975, por ka pasur ndërprerje të punës, kurse marrëdhënie të punës të pa ndërprerë ka pasur prej vitit 2001 e deri më 15.03.2020 me rastin e daljes në pension, kështu që i njëjti ka arrit përvojë të punës prej 19 vite, e që sipas dispozitave ligjore të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk i takon. Gjithashtu ka parashtruar se me hyrjen në fuqi datë 01.01.2015 të MPKK e deri në paraqitjen e padisë në gjykatë kanë kaluar më shumë se tri vite, do të thotë se padia është parashkruar me dispozitat e nenit 87 të Ligjit të Punës. Njëkohësisht ka theksuar sa i përket thirrjes së vendimit të paditurës nr.8261 datë 23.08.2019, bazuar në kriteret e përcaktuara në këtë vendim paditësi nuk e ka zënë afatin për vitin jubilar. Bazuar në të cekurat, gjykatës në fund i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, ka caktuar seancë gjyqësore dhe pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.149/2020 të 24.03.2022 me të cilin refuzuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në arsyetimin e këtij aktgjykimi, gjykata e shkallës së parë theksoi paditësi në bazë të kontratës së punës nr.7122/0 të datës 01.10.2016 dhe kartelës së punëtorit-paditësit nr.ID.7122 të datës 08.01.2020 ishte në marrëdhënie të punës tek e paditura në pozitën manipulante i kabinës, kurse nga lista e pagës shihet se lartësia e saj për muajin nëntor të vitit 2019 ishte 678.00 euro. Kurse nga vendimi i të paditurës 10778 datë 27.11.2019, paditësit i është refuzuar kërkesa e parashtruar lidhur me pagesën e pagave jubilarë. Përvoja e punës e paditësit është 42 vite, 8 muaj

e 8 ditë në kohën e parashtrimit të padisë. Sipas nenit 87 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 “*të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*”. Kurse sipas nenit 357 të LMD-së “*kërkesat për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhen për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dënimin për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin*”. Gjykata gjeti se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, ka hyrë në fuqi nga data 01.01.2015, së këndejmi, e drejta e kërkesës në kuptimin material ka lindur nga data 01.01.2015, kurse padia është paraqitur me datë 10.01.2020, andaj nga provat shkresore por edhe nga pohimet e palëve ndërgjyqëse, gjykatës i rezultoi të jetë fakt i vërtetuar se kërkesëpadia e paditësit është e parashkruar. Kurse lidhur me pretendimin e përfaqësuesit të paditësit, se vetë e paditura ka vazhduar me njohjen e pagave jubilarë të punësuarve që kanë arritur përvojën e punës 10, 20 30 vite, gjykata vlerëson se në këtë vendim të paditurës është përcaktuar zgjidhja se do t’ju njihen pagat jubilarë, për të punësuarit që kanë arritur përvojën e punës 10,20 30, porse paditësi pas arritjes së përvojës së punës prej me shumë 35 vite kërkon një të drejt të tillë. Vendimin për shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi vlerësimin dhe përfundimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti aktgjykim nuk është i përfshirë në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale për arsyeje se: Me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 të datës 01.11.2010, përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet se “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes*”. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se “*Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 4 përcaktohet se “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet*” Me paragrafin 5 përcaktohet se “*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive*”.

Me nenin 52 paragrafi 1, të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës të datës 01.01.2015, përcaktohet se “*I punësuarit, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: 1.1.për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij; 1.2.për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij; 1.3.për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij*”. Paragrafi 2 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës parashesh se “*Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë*”. Paragrafi 3 i nenit

52 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive parasheh se “*Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf*” .

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata e Apelit, e ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, për arsye se paditësi kërkesëpadinë e tij e ka mbështetur në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive e Kosovës të lidhur dhe nënshkruar nga Organizatat e Punëdhënësve (Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit), Organizatat e të Punësuarve (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës) si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e cila marrëveshje është aplikuar nga data 01.01.2015 e deri me datën 31.12.2017, pra kjo marrëveshje nuk ka qenë në fuqi në kohën e arritjes së vitit jubilar për paditësin. Gjykata e Apelit vlerëson se dispozitat e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës prodhojnë efekt juridik vetëm për të drejtat të cilat janë njohur me këtë kontratë, të cilat kanë arritur brenda periudhës kohore të vlefshmërisë së saj, pra vetëm për të drejtat që kanë lindur nga data 01.01.2015 e deri me datë 31.12.2017

Në këtë kuptim, meqë sipas kartelës së punëtorit të lëshuar nga e paditura me datë 08.01.2020, vërtetohet se paditësi, marrëdhënien e punës tek e paditura e ka themeluar me datë 26.09.1975 që do të thotë se vitin jubilar prej 30 viteve të përvojës së punës e ka arritur në vitin 2005. Në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pa themeltë dhe paditësit nuk i takojnë benefitet nga Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, ngase Marrëveshja nuk ka qenë në fuqi në kohën kur paditësi e ka arritur vitin jubilar për 30 vite përvojë pune e që i bie të jetë data 26.09.2005, andaj kërkesëpadisë i mungon bazë ligjore për të përfituar shpërblimin jubilar ashtu siç e parasheh neni 52 i Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës.

Gjykata e Apelit, vlerëson se paditësit nuk i takon e drejta e kompensimit të shpërblimit jubilar as në bazë të vendimeve të paditurës me numër 2244 të datës 10.04.2019 dhe numër 8261 të datës 23.08.2019, e cila i njih edhe të drejtën e realizimit të pagëva jubilarë për 40 vite të përvojës së punës e kjo për faktin se në rastin konkret nuk plotësohen kushtet e parapara me këto vendime sepse referuar vendimeve të të paditurës parashihet se “*Vazhdohet njohja e obligimit për pagesën e pagave jubilarë për të gjithë punëmarrësit që kanë plotësuar kushtin deri me datë 31.12.2019, pra që kanë arritur përvojën e punës 10, 20 apo 30 vite, prej datës 01.01.2015 dhe në vazhdimësi*”. Referuar rastit të paditësit, ka rezultuar se i njëjti vitin jubilar prej 40 vitesh e ka arritur me datë 26.09.2015, kur është aplikuar Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës (nga data 01.01.2015 deri me datën 31.012.2017), ndërsa padinë e ka ushtruar me datë 10.01.2020, pra 5 (pesë) vite pasi që e ka krijuar bazën ligjore për të realizuar të drejtën e tillë. E paditura në përgjegjeje në padi është thirrur në institucionin e parashkrimit, andaj gjykata duke e vlerësuar prapësimin e të paditurës e refuzoi kërkesëpadinë e paditësit si të parashkruar sipas nenit 87 të Ligjit të Punës 03/L-212 e cila parasheh se “*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*”.

Gjykata e Apelit, vendimin për shpenzimet e procedurës, që secila palë t’i bartë shpenzimet e saj të procedurës, e ka bazuar në kuptim të nenit 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo gjeti se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1, pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.4571/2022, datë 16.04.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari,
Ardian Ajvazi